



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1221/1 Prot.

Tiranë, më 08.09. 2025

V E N D I M

Nr. 209, Datë 08. 09. 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 182, datë 13.08.2025, të paraqitur nga z. S.C, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar për shkak të mos zbatimit të nenit 11, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi S.C parashtron ndër të tjera se është një person me aftësi të kufizuara fizike dhe banon në Njësinë Administrative Nr.7, Tiranë.

Ankuesi pretendon se diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar si pasojë e mos zbatimit të nenit 11, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”, ku parashikohet: “*Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, bashkë me shoqëruesin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërsa udhëtimi interurban rimburohet nga shteti në masën 50 përqind të vlerës.*”

Ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e masave siç parashikon neni 11, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

LMD, rregullon zbatimimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri konstatoi se, ankesa nuk kishte informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim. Bazuar në parashtrimet që pala ankuese ka paraqitur në ankesë, u konstatua se nuk ka përcaktuar apo identifikuar ndonjë subjekt kundër të cilit paraqitet ankesa apo ndonjë situatë apo pretendim konkret kur pala ankuese është cenuar si pasojë e mos zbatimit të ligjit.

Me qëllim plotësimit të ankesës me informacionin e mjaftueshëm për të bërë të mundur vijimin e hetimit, me email-in e datës 15.08.2025, Komisioneri iu drejtuar palës ankuese me një kërkesë për informacion plotësues, duke kërkuar informacion në lidhje me situatën/situatat konkrete (nëse ka ndodhur më shumë se një herë) për të cilat pala ankuese pretendon se është cenuar nga moszbatimi i këtij detyrimi ligjor, linjën e transportit që ankuesi ka përdorur, ditën dhe orarin kur është përdorur shërbimi i transportit, të dhëna identifikuese të mjetit të transportit të përdorur ose biletën (në rast se e disponon), si dhe çdo informacion tjetër që mund të disponohej nga pala ankuese dhe që mund të shërbente për përcaktimin e sjelljes konkrete diskriminuese të pretenduar dhe të dhëna të cilat mund të shërbenin për të hetuar dhe identifikuar subjektin që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese.

Me emailin e datës 15.08.2025, pala ankuese nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion për të bërë të mundur një hetim. Ankuesi parashtroi se, ka 25 vite që nuk zbatohet

ligji dhe se për të konstatuar shkeljet Komisioneri mund të hetonte për të kuptuar se cilët autobuza nuk zbatojnë ligjin.

- *Vlerësimi i Komisionerit.*

Bazuar në nenin 4, të ligjit LMD, përcaktohet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.*

Bazuar në nenin 32, pika 1, të LMD, përcaktohet se: *“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”*

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Bazuar në nenin 33, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”.*

Bazuar në nenin 4, të LMD të marrë së bashku me nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, janë subjekte të ligjit dhe mund t’i drejtohen Komisionerit të gjithë personat fizikë dhe juridikë, si dhe çdo subjekt i së drejtës i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 32/a dhe 33/1, të LMD-së, i njohin të drejtën çdo personi ose grupi personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose organizate me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, për të paraqitur ankesë para Komisionerit.

Këto dispozita të marra së bashku me nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, kërkojnë që një person ose grup personash të kenë një interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative. Pra, në rastin konkret, që ankuesi të legjitimohet si palë në procedurën administrative para Komisionerit duhet që të ketë një interes legjitim të drejtpërdrejtë.

Për t'u legjitimuar për të paraqitur një ankesë pranë Komisionerit, ankuesi, duhet të provojë se cenohet në interesin e tij legjitim të drejtëpërdrejtë. Pra, ankuesi duhet të tregojë fakte dhe rrethana konkrete në të cilat ai pretendon se është cenuar personalisht në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë si pasojë e moszbatimit të ligjit.

Pala ankuese ka ngritur pretendimin për moszbatim të nenit 11, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*, i cili parashikon lehtësira në shërbimin e transportit urban dhe atij interurban, për personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjikut, por nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka treguar fakte dhe rrethana konkrete, në lidhje me cenimin që i është bërë atij si person me aftësi të kufizuara apo të dhëna të cilat mund t'i shërbenin Komisionerit për të hetuar dhe për të identifikuar subjektin që ankuesi pretendon se ka cenuar të drejtën e tij. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe rrethanat e pretenduara nga pala ankuese, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim të mëtijshëm, lidhur me ankesën. Ankuesi nuk provon se është cenuar në interesin e tij të drejtëpërdrejtë dhe personal.

Ankuesi nuk mund t'i drejtohet Komisionerit për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave apo interesave publike që i drejtohen një komuniteti në tërësi apo një grupi shoqëror, sikurse janë personat me aftësi të kufizuara që kanë statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjikut. Në këto kushte për të bërë një ankesë para Komisionerit do të legjitimoheshin subjektet që janë mbajtës të interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit. Megjithatë edhe në këtë rast, objekti i ankesës dhe pretendimi i ankuesit mbetet sërisht i papërcaktuar në kohë dhe hapësirë, se nga kush dhe ku, është cenuar e drejta e personave me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet respektivisht se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtijshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 182 regj., datë 13.08.2025, të paraqitur nga z. S.C, pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtijshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime/Transport
Lloji i vendimit: Mospranim